

Gjykata Kushtetuese sipas sistemit juridik shqiptar

Bashkim Dedja

Kryetar

Gjykata Kushtetuese Shqiptare

Hyrje

Në këtë prezantim të shkurtër, do të mundohem të paraqes një vështrim historik të organizimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përbërjes, kompetencave dhe vendimmarrjes së saj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton shtetin e së drejtës duke e sanksionuar që në preambulën e saj, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (*neni 15*), si dhe ndarjen e pushteteve duke e vënë atë në themel të funksionimit të demokracisë (*neni 7*). Në një republikë demokratike pushteti ekzekutiv dhe parlamentar bashkëpunojnë ngushtë në mënyrë që të nxjerrin dhe zbatojnë aktet ligjore të duhura për ecurinë e shoqërisë. Ndërsa pushteti i tretë, ai gjyqësor, është i ngarkuar me detyrën për të mbrojtur qytetarët nga cënimet e paligjshme të të drejtave të tyre qoftë edhe nga organet e pushtetit publik.

Detyra për garantimin dhe respektimin e Kushtetutës nga veprimtaria e pushtetit publik i është ngarkuar Gjykatës Kushtetuese. Ajo është instanca e fundit e ngarkuar me kontrollin ndaj akteve të nxjerra nga organet e pushtetit shtetëror, duke u përqendruar në aspektin e pajtueshmërisë së tyre me dispozitat kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e njohur ndryshe si “roje e Kushtetutës” funksion kryesor të saj ka mbrojtjen e Kushtetutës nga cënimet e mundshme të pushtetit shtetëror dhe realizimin e drejtësisë kushtetuese.

1. Historiku

Në fillim të viteve '90 shteti shqiptar dhe institucionet e tij u transformuan, transformim i pasqyruar në dispozitat kryesore kushtetuese të vitit 1991. Në këto dispozita u sanksionua dhe krijimi i Gjykatës Kushtetuese, institucion që u konsiderua nga ligjvënësi që nga fillimi si autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Prandaj dhe kontrolli kushtetues në Shqipëri lindi pikërisht me krijimin e kësaj gjykate. Legjisllacioni kushtetues dhe Gjykata Kushtetuese u ndërtuan duke u bazuar në modelin evropian (kryesisht italian dhe më pak gjerman), sipas të cilit kontrolli kushtetues është përqendruar tek një organ i vetëm, tek Gjykata Kushtetuese (modeli kelzenian).

Me miratimin e Kushtetutës në vitin 1998, Gjykata Kushtetuese zë një kapitull më vete, jashtë kapitullit ku trajtohet sistemi gjyqësor i zakonshëm (gjykatat). Ajo ka një juridiksion të veçantë për interpretimin e Kushtetutës, për kontrollin e kushtetushmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normative si dhe deklarimin e papajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Vlen të përmendim rëndësinë themelore që Kushtetuta Shqiptare i ka dhënë Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vlerës juridike në sistemin e brendshëm normativ, duke e konsideruar si pjesë të legjislacionit shqiptar dhe drejtpërdrejt të zbatueshme për dispozitat që kanë karakter të vetzbatueshëm (neni 122).

2. Organizimi

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion. Ndryshimet në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese kanë qenë prezente për shkak të zbatimit të kërkesave të ligjit kushtetues për përtëritjen e saj, të dorëheqjes së disa prej anëtarëve dhe apo edhe të vdekjes para mbarimit të mandatit të gjyqtarit. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar me ligj (neni 125/3). Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e ndryshme, të dëmshme për ushtrimin e detyrës së tij. Vetëm një gjykatë e pavarur, të cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë.

Rotacioni i gjyqtarëve me 1/3 e anëtarësisë, ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve me stazh në detyrë, çka bën të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme dhe të specializuar në gjykimin kushtetues, e cila nuk mund të përftohet askund tjetër. Kjo bazë njohurish tekniko-juridike në fushën e gjykimit kushtetues, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes, konsiderohet si një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta.

Kushtetuta në funksion të garantimit të pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese ka gjetur formulën e përbërjes së gjykatës, të tillë që, të respektojë qëndrueshmërinë në përbërjen e Gjykatës dhe kohëzgjatje të mandatit të gjyqtarit kushtetues.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarët kushtetues gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të ndiqen penalisht pa pëlqimin e vetë Gjykatës Kushtetuese (*neni 126*). Gjithashtu ata nuk mund të shkarkohen, përveç se në rastet e parashikuara nga Kushtetuta (*neni 128*). Gjithashtu funksioni i gjyqtarit kushtetues është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër publik ose veprimtari private (*neni 130*).

3. Kompetencat

Gjatë ushtrimit të funksionit të saj Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (*neni 124 i Kushtetutës*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ shtetëror për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar, pasi kjo krijon mundësinë e mënjanimin të mosmarrëveshjeve ose paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre (*vendimi nr.75/2002; nr.18/2003; nr.2/2005; nr.29/2009, nr.24/2011*).

Gjykata Kushtetuese vendos për: (i) papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare si dhe papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre; (ii) papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare; (iii) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore; (iv) kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike si dhe të veprimtarisë së tyre; (v) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij; (vi) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të

deputetëve si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre; (vii) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij; (ix) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave (neni 131). Kjo kompetencë e saj për të shqyrtuar ankimet individuale kushtetuese është e kufizuar vetëm në lidhje me elementet procedurale të procesit të rregullt ligjor, dhe jo edhe për kontrollin substancial të procesit.

Nga kompetencat e lartpërmendura, kontrolli i marrëveshjeve ndërkombëtare është një nga kompetencat më të veçanta të Gjykatës Kushtetuese, për faktin se i duhet të vlerësojë respektimin e normave dhe parimeve kushtetuese në fushën e marrëdhënieve me jashtë, të cilat janë jo vetëm çështje të rendit të brendshëm kushtetues të një vendi por edhe të së drejtës ndërkombëtare, për aq sa shteti merr përsipër të drejta dhe detyrime (*vendimi nr.15/2010*).

Gjykata Kushtetuese gjithashtu vendos edhe mbi kushtetutshmërinë e: (i) vendimit të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës (*neni 90/3, 91/2*); (ii) vendimit të Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (*neni 140*); (iii) vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kryetarëve të komunave ose bashkive (*neni 115*); (iv) jep pëlqimin për ndjekjen penale ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (*neni 126*) dhe të Gjykatës së Lartë (*neni 137/2*).

Gjykatën Kushtetuese mund ta vënë në lëvizje këto subjekte: a) Presidenti i Republikës; b) Kryeministri; c) Një e pesta e deputetëve (28 deputete); c) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; d) Gjykatat; dh)Avokati i Popullit; e) Organet e qeverisjes vendore; e) Organet e bashkësive fetare; f) Partitë politike dhe organizatat e tjera; g) Individët.

Kërkesat që vijnë para Gjykatës Kushtetuese pasi regjistrohet, i caktohen nga Kryetari i Gjykatës një gjyqtari në rolin e relatorit, i cili përgatit relacionin dhe materialet përkatëse për shqyrtimin paraprak të çështjes. Relatori ia paraqet çështjen kolegjit prej tre anëtarësh, në të cilin mund të bëjë pjesë dhe ai. Kolegji vendos për pranueshmërinë e kërkesës, pra kalimin e saj në seancë plenare. Nëse kolegji nuk arrin të vendosë unanimitisht, çështja i paraqitet mbledhjes së gjyqtarëve, që vendos me shumicë votash. Çështja nuk pranohet të kalojë në seancë kur objekti i saj nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, apo kur kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Seancat plenare zhvillohen të hapura pergjithsisht duke respektuar parimin e kontradiktoritetit si dhe parimet e tjera themelore të gjykimit në përgjithësi dhe atij

kushtetues në veçanti. Në disa raste gjykimi mund të zhvillohet edhe vetëm mbi bazën e dokumentave. Palët mund të përfaqësohen me avokatë. Procedurat gjyqësore janë pa pagesë.

4. Vendimmarrja dhe efektet e saj

Në fund të çdo shqyrtimi gjyqësor Gjykata Kushtetuese shprehet me vendim. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Seanca është e vlefshme kur marrin pjesë të paktën 6 anëtarë dhe vendimi është i vlefshëm kur për të votojnë “pro” 5 anëtarë. Abstenimi nuk lejohet. Pesha e votës është e barabartë. Kryetari është në pozicionin *primus inter pares* (i pari mes të barabartëve). Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese arsyetohen me shkrim dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur ajo vendos ndryshe. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të formës së prerë. Si rregull, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë fuqi prapavepruese. Megjithatë ligji parashikon rastet përjashtimore të tilla si: (i) vendimet që shfuqizojnë dënimet penale, qofshin këto edhe në fazën e ekzekutimit të tyre; (ii) vendimet që interpretojnë Kushtetutën; (iii) vendime që lidhen me pasoja ende të paezauruara të aktit normativ të shfuqizuar; (iv) për çështjet në proces të gjykatave derisa vendimet nuk kanë marrë formë të prerë (*neni 76 i ligjit organik*).

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që deklarojnë papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën kanë karakter *erga omnes* (kundrejt të gjithëve). Vendimi që deklaron si të papajtueshme me Kushtetutën një dispozitë të një ligji apo dhe atë në tërësi ka detyrueshmëri të përgjithshme sepse i përgjithshëm është vetë objekti i tij. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në lidhje me efektet e vendimeve të saj, se ato janë të detyrueshme mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese. (*vendimet nr. 5, datë 07.02.200; nr.14, datë 03.06.2009; nr. 21, datë 29.04.2010*).

Konkluzione

Në këtë prezantim, u mundova të përmbledh shkurtimisht disa nga elementet kryesore të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare. Ky institucion pas gati 19 vjetësh veprimtari (1992-2011), po konsolidohet gjithmonë e më shumë, si në kuadrin funksional të vendimmarrjes ashtu edhe në aspektin organizativ të tij. Kjo gjykatë nëpërmjet ushtrimit të kontrollit kushtetues ka luajtur rol tepër të rëndësishëm në funksion të zhvillimit, elaborimit dhe konsistencës së standarteve kushtetuese.

Në fund do të doja ta mbyllja prezantimin me vlerësimin që i është bërë këtij institucioni në Raportin Analitik të Komisionit European (KE-së)¹, *“Gjykata Kushtetuese ka demonstruar pavarësi në rritje që nga viti 2005. Në një sërë çështjesh, ajo ka shfuqizuar apo pezulluar ligje të miratuara. Gjatë periudhës 2007-2010, 33 ligje kanë qenë objekte të kontrollit kushtetues: prej tyre 18 janë gjetur pjesërisht antikushtetues, 2 plotësisht antikushtetues dhe në 13 raste Gjykata rrëzoi kërkesat për antikushtetutshmëri.*

Falemnderit per vemendjen!

¹ “Opinion mbi Aplikimin e Shqipërisë për Antarësim në BE” (dokumenti {COM(2010) 680}), në pjesën “B” (Kriteret e anëtarësimit), pika “1” (Kriteret Politike), nënpika “1.1” (Demokracia dhe Shteti i së Drejtës), faqja 9.